**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA CËRRIK**

Data: 09.10.2024

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT**: "*Ndertimi i sheshit rekreativ, Shtermen"*
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (**CPV**): Punime ndërtimi për qëndra argëtimi 45212171-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 22,821,429 (*njezete e dy milion e teteqind e njezete e nje mije e katerqind e njezete e nente*) leke pa TVSH.

Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj", Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve" - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.
Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor **Bashkia CERRIK** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

**Argumentimi**:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara*

*nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*
*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
**Argumentimi**: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", ne te cilen eshte e parashikuar se:
*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*
*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*
*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*
*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës*, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik
**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale**
Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

**Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit qe prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

***Argumentimi:*** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten","Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik": Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar''. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për ketë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo*

*tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 *(tre)* viteve të fundit **(2021, 2022, 2023)**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues eshte ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

*Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 3,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh qe lloji i procedures eshte “e hapur”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte ne nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontrates.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme sipas percaktimeve të VKM-se Nr. 285, datë 19.5.2021, neni 39, pika 5:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se *se 50% e vlerës se përllogaritur të kontratës që prokurohet*, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

***ose***

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga momenti i prokurimit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në këtë bashkim.*
*Në rastin kur operatoret ekonomikë anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*
Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtem:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike:
- Kontratë sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Fatura tatimore e situacionit përfundimtar
- Aktin e kolaudimit
- Çertifikaten e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës Nr. 9

*Shënim: Formulari i vlerësimit ne rastin e punes se ngjashme te kryer nga BOE duhet te tregoje saktesisht % e ndarjes se punes midis OE. Paraqitja e nje formulari te mbushur jo sipas formatit zyrtar, do te kosiderohet kusht per mosnjohjen e punes respektive.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:
- Kontrate sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit*(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat, për kyerjen me sukses të kontratës
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmoje se dispononë liçense profesonale për zbatim punimesh në ndertim, duke perfshire kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet tëparaqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008*"Për miratimin e rregullorespër kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të*

*Subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi"*, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
  - ***N.P-2*** *(Ndërtime civile dhe industriale)* ***Niveli A***
  - ***N.P-4*** *(Rruge,autostrada,mbikalime,)* ***Niveli A***
  - ***N.P-5*** *(Punime nentokesore, ,)* ***Niveli A***
  - ***N.P-12*** *(Punime te inxhinjerise se mjedisit)* ***Niveli A***
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
  - ***N.S.-2*** *(Impiante hidrosanitare,)* ***Niveli A***
  - ***N.S.-4*** *(Punime rifiniture te muratures,)* ***Niveli A***

  sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

*Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".*

*Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).*

***Argumentimi**:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit",neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në perputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| *Kategoria e kërkuar* | *Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës* | *Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse* | *Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive* | *Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse* |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **N.P-2** | Ndërtime civile dhe industriale | Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.<br>III. FUSHA E BASKETBOLLIT & DHOMAT E ZHVESHJES<br>*Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25*<br>*Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m*<br>*Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m*<br>*Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m*<br>*Mur me tulle te lehtesuara 20 cm deri 3m me llaç perzier M25*<br>*Shtrese me pllaka grez porcelanato* | *A* | *0-20 milion* |
| **N.P-3** | Rikonstuksion dhe mirembajtje | BASKETBOLLIT & DHOMAT E ZHVESHJES<br>*Dritare d/alumini dyfish xham.*<br>*Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a.*<br>*Boje hidroplastike cilesi e larte*<br>*F.V kuader ndriçimi*<br>*F.V Çeles 1 polar 220V 10A*<br>*F.V percjelles PV-500 ø 1.5 mm2*<br>*F.V tub plastmasi Ø 22-26mm*<br>*F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A* | A | *0-20 milion* |
| **N.P-4** | Rruge,autostrada,mbikalime | Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e | A | *0-20 milion* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, **sheshet** të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objek.<br>*Mur me tulle te lehtesuara 20 cm deri 3m me llaç perzier M25*<br>*Shtrese me pllaka grez porcelanato*<br>*Shtrese llluster cimento 1:2,* | | |
| ***N.P-5*** | Punime nentokesore, ura e vepra arti | *Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.* | A | *0-20 milion* |
| NP-12 | Punime te inxhinierise se mjedisit. | *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në* | A | *0-20 milion* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | *territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të vepra. Per shkak te punimeve qe do te kryeen dhe mbetjet qe do te prodhojne te cilat mund te ndikojne ne ndotjen e mjedisit.* | | |
| ***N.S.-2*** | Impiante hidrosanitare | *F V bolier 80 liter, uje te ngrohte*<br>*FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16*<br>*FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16*<br>*F.V pilete dyshemeje Ø 30* | A | *0-20 milion* |
| **N.S.-4** | Punime rifiniture te muratures | *Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.*<br>*Mur me tulle te lehtesuara 20 cm deri 3m me llaç perzier M25*<br>*Shtrese lluster cimento 1:2, t = 20 mm*<br>*Suva solete ~ 4 m me* | A | *0-20 milion* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | *drejtues, me krah*<br>*Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25*<br>*Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m*<br>*Boje hidroplastike cilesi e larte* | | |

**2.3.3.** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë *(nga Administratori i shoqërisë)* Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklaroje se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune.

i. Libreze pune (përkatëse)
ii. C.V (përkatëse)
iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
iv. Diplomë

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.*

***Argumentimi****:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar per keto punime:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqerisë, inxhinerët e mëposhtëm:

- Minimuni **1** *(një)* **Inxhinier Ndertimi**
- Minimuni **1** *(një)* **Inxhinier Elektrik**
- Minimuni **1** *(një)* **Inxhinier Mjedisi**
- Minimuni **1** *(një)* **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kerkesave te meposhtme:

- Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e

zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune *(e vlefshme)*, librezë pune, C.V.
*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.4.1.** Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Minimuni **1** *(një)* **Inxhinier Mekanik**

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".*

*Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe C.V.*

**2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:**

a) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Auditues energjetik** (i çertifikuar nga **Agjensia për Efiçencën e Energjisë në ndertesa**),
(Për ekspertin Auditues Energjetik te paraqiten Certifikata perkatese leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise si dhe Kontrata e punes (e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisëte pakten 3 (tre) muajt e fundit).

**b)** **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Ekspert Zjarrfikes** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**,**
(Për ekspertin zjarrfikës çertifikata e ekspertit zjarrëfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).

c) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për ***"Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune"***, ***"Pergjegjes per sigurine"***, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,

d) Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, **1(nje)** person te certifikuar per ***"Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"***, i cili duhet te figurojne ne listepagese minimalisht per 3 (tre) muajt e fundit).

e) Operatori ekonomik duhet te kete ne stafın e tij **2 (dy)** persona specialist te certifikuar per **"Punime ne lartesi"**, te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.

f) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1(nje)** mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje (konform ligjit per cdo kompani me mbi 15 punetore). Mjeku duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit.*

<u>**Shenim:**</u> Per piken **2.3.5** me nenpikat, si me siper, operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST.

**Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se kontrates, te gjithe dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit**.

***Argumentimi per pikat : 2.3.4, 2.3.5*** Kërkesat e mësipërme jane vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor Teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mire në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 1 "Drejtuesi teknik i shoqërisë", gërma b) parashikohet: "Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Percaktimi i kerkeses per Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetem per angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

Kërkesa per certifikate per "sigurine dhe shendetin ne pune" është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :Kërkesa e mësiperme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëyrjes.

| Personeli i kerkuar | Punimet pjese e preventivit perkates |
|---|---|
| **1** *(një)* **Inxhinier Ndertimi** | Eshte pergjegjes per zbatimin e projektit per punimet e ndertimit si : *Shtrese çakelli t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri (Pedonale + trotuare +rruga)* |

| | |
|---|---|
| | *Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri*<br>*Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri*<br>*Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka*<br>*F V bordura betoni 15x25cm*<br>*Shtrese rere*<br>*Struktura monolite betoni C 20/25*<br>*Trotuar me shtrese te gomuar 4 cm (Ngjyre e Kuqe)*<br>*Shtrese pllaka guri 20x120 cm*<br>*Shtrese betoni C 12/15 nen bordure*<br>*Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25*<br>*Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m*<br>*Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m*<br>*Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m*<br>*Mur me tulle te lehtesuara 20 cm deri 3m me llaç perzier M25*<br>*Shtrese me pllaka grez porcelanato*<br>*Shtrese lluster cimento 1:2, t = 20 mm*<br>*Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah*<br>*Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25*<br>*Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m* |
| **1** *(një)* **Inxhinier Elektrik** | Inxhinieri i ndertimit eshte i nevojshem per te ndjeku gjitha punimet elektrike e perkateisht ne zerat *: PUNIME ELEKTRIKE, F.V.ne toke kabllo Al fu ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, armuar, 4x25mm2*<br>*F.V.ne toke kabllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gom mbulese plastmasi, te armuar, 4x10mm2*<br>*F.V.kabllo kontrolli Cu te armuar, ne toke, 4x1.5 mm2*<br>*F.V ndricuesLed 100-130 w,120 lm/wat,IP 66,40 6400K*<br>*F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoeleme*<br>*FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10*<br>*F V shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm*<br>*FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm*<br>*Mbushje me beton marka 150 per ikastrim shtyllash*<br>*F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm*<br>*F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A*<br>*Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 150* |
| **1** *(një)* **Inxhinier Mjedisi** | Është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi. |
| **1** *(një)* **Inxhinier Mekanik** | Eshte kerkuar ky inxhinier per arsye se mund te kete problematika gjate zbatimit te punimeve dhe mund te kete ndryshime dhe rregullime te cilave mund ti pergjigjet gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren |

| | |
|---|---|
| | gjate zbatimit te punimeve |
| **1** *(një)* **Inxhinier Hidroteknik** | Eshte kerkuar ky inxhinier per te ndjekur te gjitha punimet hidraulike në tw gjitha fazat, që nga projekt-ideja, zbatim dhe kolaudim përfundimtar;<br>*F.V lavaman porcelani*<br>*F.V WC allafrenga*<br>*F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110*<br>*F V bolier 80 liter, uje te ngrohte*<br>*FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16*<br>*FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16*<br>*F.V pilete dyshemeje Ø 30* |
| • Minimuni 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder | Eshte i domosdoshem per te ndjekur dhe zbatuar punet ne terren. Pas piketimit tekniku nevojitet per te nxjerre matjet ,kuotat dhe volumet per zbatim. |

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **50** *(pesedhjete)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës perkatese në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore te nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit te çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve*"Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve per objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore ne dite për cdo punonjës) afatit kohor te realizimit te kontrates si dhe shperndarjes se punes.

| **Nr.** | **Nr. An** | **EMËRTIMI I PUNIMEVE** | **NJËSIA** | **SASIA** | **Ore pune** | **Ore pune total** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **I. PUNIME GERMIMI DHE SISTEMIM SHESHI + RRUGA** | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3.87/a | Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke | m3 | 600.00 | 0.094 | 56.40 |
| 2 | 3.164/1a | Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri | m3 | 115.00 | 0.34 | 39.10 |
| 3 | 3.158/1a | Transport dheu me auto deri 1.0 km | m3 | 485.00 | 1 | 485.00 |
| **SHUMA I** | | | | | | - |
| **II. PUNIME PEDONALE / TROTUARE DHE SHTRESA RRUGORE** | | | | | | - |
| 1 | 3.211 | Shtrese çakelli t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri (Pedonale + trotuare +rruga) | m2 | 1,500.00 | 0.28 | 420.00 |
| 2 | 3.222/2 | Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri | m2 | 500.00 | 0.12 | 60.00 |
| 3 | 3.226/1 | Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri | m2 | 500.00 | 0.1 | 50.00 |
| 4 | 3.62 | Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka | m2 | 400.00 | 2.14 | 856.00 |
| 5 | 3.616/a | F V bordura betoni 15x25cm | m | 500.00 | 0.8 | 400.00 |
| 6 | 2.261 | Shtrese rere | m3 | 11.70 | 2.18 | 25.51 |
| 7 | 3.244 | Struktura monolite betoni C 20/25 | m3 | 150.00 | 12.8 | 1,920.00 |
| 8 | An | Trotuar me shtrese te gomuar 4 cm (Ngjyre e Kuqe) | m2 | 550.00 | 0 | - |
| 9 | 3.639 | Shtrese pllaka guri 20x120 cm | m2 | 100.00 | 1.15 | 115.00 |
| 10 | 2.262/3 | Shtrese betoni C 12/15 nen bordure | m3 | 50.00 | 8.6 | 430.00 |
| 11 | 3.616 | F V bordura betoni 12x25cm | m | 740.00 | 0.75 | 555.00 |
| **SHUMA II** | | | | | | - |
| **III. FUSHA E BASKETBOLLIT & DHOMAT E ZHVESHJES** | | | | | | - |
| 1 | 3.193/a | Shtrese zhavor lumi t=10cm, me cilindrim | m2 | 636 | 0.13 | 82.68 |
| 2 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 shtrimi sheshit | m3 | 95 | 12.8 | 1,216.00 |
| 3 | 2.262/4 | Shtrese betoni C 16/20 t=5cm epunuar me helikopter | m3 | 32 | 8.6 | 275.20 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 3.946 | Vizime me boje bikomponente | m2 | 50 | 0.1 | 5.00 |
| 5 | 3.17 | Germime dheu ne seksion te lire me krahe,ne toke te bute,kateg.I-II, pa hedhje | m3 | 5 | 3.8 | 19.00 |
| 6 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 (Plintat e rrethimit) | m3 | 4 | 12.8 | 51.20 |
| 7 | 2.182 | Konstruksione metalike te thjeshta(Rrethimi fusha+sheshi) | ton | 11 | 36 | 396.00 |
| 8 | 2.401 | Boje vaji siperfaqe metalik | m2 | 180.93 | 1.47 | 265.97 |
| 9 | 3.837/a | Rrethim rruge me rrjete teli | m2 | 408 | 2 | 816.00 |
| 10 | 2.262/3 | Shtrese betoni C 12/15 nen bordure | m3 | 3 | 8.6 | 25.80 |
| 11 | 3.616/a | F V bordura betoni 15x25cm | m | 104 | 0.8 | 83.20 |
| 12 | An | Porta sporti | cope | 2 | | - |
| 13 | 2.258 | Nenshtrese zavori | m3 | 3 | 1.2 | 3.60 |
| 14 | 2.262/3 | Shtrese betoni C 12/15 | m3 | 3 | 8.6 | 25.80 |
| 15 | 2.262/4a | Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25 | m3 | 13 | 3.46 | 44.98 |
| 16 | 2.117/1a | Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m | m3 | 3 | 31.22 | 93.66 |
| 17 | 2.119/1a | Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m | m3 | 2 | 20.6 | 41.20 |
| 18 | 2.122/1a | Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m | m3 | 5 | 22.89 | 114.45 |
| 19 | 2.70/2 | Mur me tulle te lehtesuara 20 cm deri 3m me llaç perzier M25 | m3 | 21 | 15.7 | 329.70 |
| 20 | 2.267/a | Shtrese me pllaka grez porcelanato | m2 | 17.5 | 1.66 | 29.05 |
| 21 | 2.264 | Shtrese lluster cimento 1:2, t = 20 mm | m2 | 17.5 | 0.66 | 11.55 |
| 22 | 2.3 | Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah | m2 | 15.12 | 2.85 | 43.09 |
| 23 | 2.31 | Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 | m2 | 52 | 1.55 | 80.60 |
| 24 | 2.331 | Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m | m2 | 36.4 | 2.18 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 79.35 |
| 25 | 2.375/a | Dritare d/alumini dyfish xham. | m2 | 2 | 2.64 | 5.28 |
| 26 | 2.395/a | Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a. | m2 | 2 | 2.4 | 4.80 |
| 27 | 2.404/1 | Boje hidroplastike cilesi e larte | m2 | 103.52 | 0.36 | 37.27 |
| 28 | 2.49 | F.V kuader ndriçimi | cope | 1 | 3.1 | 3.10 |
| 29 | 2.485/1 | F.V Çeles 1 polar 220V 10A | cope | 4 | 1 | 4.00 |
| 30 | 2.481/1 | F.V percjelles PV-500 ø 1.5 mm2 | ml | 20 | 0.04 | 0.80 |
| 31 | 2.480/3 | F.V tub plastmasi Ø 22-26mm | ml | 15 | 0.43 | 6.45 |
| 32 | 2.490/1b | F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A | cope | 2 | 1.3 | 2.60 |
| 33 | 2.490/d | F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende) | cope | 4 | 2.5 | 10.00 |
| 34 | 2.561 | F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w | cope | 2 | 0.1 | 0.20 |
| 35 | 2.487/b | F.V kuti suport pllaket 4 mod | cope | 4 | 0.25 | 1.00 |
| 36 | 2.481/4 | F.V percjelles PV-500 ø 6 mm2 | ml | 10 | 0.07 | 0.70 |
| 37 | 2.166 | F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm | ton | 2.29 | 60 | 137.40 |
| 38 | 2.166/1a | F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm | ton | 2.17 | 42 | 91.14 |
| 39 | 2.495 | F.V lavaman porcelani | copë | 1 | 2.95 | 2.95 |
| 40 | 2.501 | F.V WC allafrenga | copë | 1 | 3.70 | 3.70 |
| 41 | 2.52 | F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110 | ml | 75 | 1.43 | 107.25 |
| 42 | 2.215 | F V bolier 80 liter, uje te ngrohte | copë | 2 | 7.00 | 14.00 |
| 43 | 2.491/b | FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16 | ml | 45 | 0.30 | 13.50 |
| 44 | 2.491/c | FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, | ml | 30 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Pn 16 | | | 0.25 | 7.50 |
| 45 | 2.513 | F.V pilete dyshemeje Ø 30 | copë | 2 | 1.70 | 3.40 |
| 46 | An | Dollap per veshje/zhveshje me përmasa (gjerësi x thellësi x lartësi) 100x50x200 cm | copë | 2 | 0 | - |
| 47 | An | Stola druri | copë | 2 | 0 | - |
| **SHUMA III** | | | | | | - |
| **IV. GJELBERIMI** | | | | | | - |
| 1 | 2.19 | Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krah, kategoria III | m3 | 520 | 0.42 | 218.40 |
| 2 | 3.966 | F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar (cdo 6m) | cope | 5 | 1 | 5.00 |
| 3 | 3.961 | F.V. Fidane Peme dekorative | cope | 45 | 1 | 45.00 |
| 5 | 3.96 | F.V. Fidane Lule dekorative | cope | 100 | 1 | 100.00 |
| 6 | 3.643 | Mbjellje bari | m2 | 2000 | 0.17 | 340.00 |
| **SHUMA IV** | | | | | 0 | - |
| **V. SHESHET E LODRAVE** | | | | | 0 | - |
| 1 | 3.87/a | Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke | m3 | 20.00 | 0.094 | 1.88 |
| 2 | 2.258 | Nenshtrese zhavori nen bordura 5 cm | m3 | 3.00 | 2.9 | 8.70 |
| 3 | 3.242 | Struktura monolite betoni C 12/15 nen bordura | m3 | 2.00 | 13 | 26.00 |
| 4 | 3.616/a | F V bordura betoni 15x25cm | m | 78.00 | 0.8 | 62.40 |
| 5 | 3.182/c | Shtrese rere natyrore t=20cm | m2 | 180.00 | 0.12 | 21.60 |
| 6 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 (fiksim te paisjeve) | m3 | 3.00 | 12.8 | 38.40 |
| 7 | 3.158/1a | Transport dheu me auto deri 1.0 km | m3 | 20.00 | 1 | 20.00 |
